



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT PËR KRYETAR BASHKIA POLIÇAN, z. ADRIATIK MALIQ ZOTKAJ NË ZBATIM TË LIGJIT NR.138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar Bashkia Poliçan, z. Adriatik Maliq Zotkaj në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, i Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, gërma a i ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 365 i vendimit Data 15.05.2019 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar, Bashkia Poliçan, Z.Adriatik Maliq Zotkaj , në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VËREN

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e Z. Adriatik Maliq Zotkaj si kandidat për kryetar të bashkisë Poliçan.

Gjithashtu z.Adriatik Maliq Zotkaj në përputhje me nenin 5, pika 4, gërma a të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni Kryetarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, nëse është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, të z. Adriatik Maliq Zotkaj rezulton se:

- Me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, nr.20 datë 29.07.1985 është deklaruar fajtor për veprën penale "Fyerje dhe goditje për shkak të detyrës", parashikuar nga neni 206, neni 119 Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe është dënuar më 200 mijë lekë gjobë, 4 muaj riedukim nëpërmjet punës dhe ¼ e pagës mujore.
- Me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është deklaruar fajtor për veprën penale "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 81 Kodi Penal i dhe është dënuar me 3 vjet burgim.
- Me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, nr.03 datë 01.02.2001 është deklaruar fajtor për veprën penale "Kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit publik", parashikuar nga neni 236/1 Kodi Penal dhe është dënuar më 10 muaj burgim.
- Me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.370 datë 21.05.2002 është deklaruar fajtor për veprën penale të kryerjes se veprimeve arbitrare, fallsifikimit të dokumentave, parashikuar nga neni 250, neni 187/1 Kodi Penal dhe është dënuar me 1 vit burgim.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa b dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", me shkresat nr. 3449 prot., datë 15.05.2019 dhe nr. 3451 prot., datë 13.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes dhe zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për Kryetar Bashkie, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezulton se;

- 1- Me vendim nr.20, datë 29.07.1985, Gjykata e Rrethit Skrapar e ka deklaruar fajtor për veprën penale të fyerjes për shkak të detyrës, goditjes për shkak të detyrës, parashikuar nga neni 206, 119, 35 k.p. e dënon me 4 muaj riedukim nëpërmjet punës duke ju ndalur 1/4 e pages mujore. Rehabilituar në bazë të nenit 69 k.penal.



Nr . 365 i vendimit Data 15.05.2019 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar, Bashkia Poliçan, Z.Adriatik Maliq Zotkaj , në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- 2- Me vendimin nr.56 datë 19.03.1992, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e ka deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale "shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga neni 81/2 dhe 32 i kp dhe e dënon me 2 vjet e 6 muaj heqje lirie. Gjykata e zones Korçë me vendim nr.18 dt.09.04.1992 ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit te mesipërm.
- 3- Me vendim nr.03, dt.01.02.2001 Gjykata Rrethit Gjyqësor, Skrapar e ka deklaruar fajtor për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik, parashikuar nga neni 236/1 k.p. e dënon me 10 (dhjetë) muaj burgim. Gjykata e Apelit Vlorë me vendim nr.190, datë 24.07.2001 vendosi mospranimin e ankimit. Rehabilituar me vendim nr.253, datë 08.09.2016 te Gjykates Rrethit Gjyqësor Berat.
- 4- Me vendim nr.370(170), datë 21.05.2002 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor per veprën penale të kryerjes se veprimeve arbitrare, fallsifikimit te dokumentave, e ne baze te nenit 250, 187/1, 55 k.p.denohet me 1 (nje) vit burgim. rehabilituar me vendim nr.253, datë 08.09.2016 të Gjykates Rrethit Gjyqësor Berat.
- 5- Në bazë të vendimit nr. 253, datë 08.09.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat ka vendosur: Të konstatoj të rehabilituar nga dënimet penale të dhëna me vendimet nr.3, datë 01.02.2001 dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Skrapar dhe Vendimin nr.370(170), datë 21.05.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe mbas datës 14.06.2007 të konsiderohet me gjendje i padënuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se dhënat e deklaruara nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit sipas ligjit 138/2015. Gjithashtu KQZ ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, gërma f të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, dhe 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Poliçan, Qarku Berat, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa a, e Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, gërma f, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Nr . 365 i vendimit Data 15.05.2019 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar, Bashkia Poliçan, Z.Adriatik Maliq Zotkaj , në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Njoftimin e KZAZ-së nr. 65 për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Poliçan, Qarku Berat, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 365 i vendimit Data 15.05.2019 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar, Bashkia Poliçan, Z.Adriatik Maliq Zotkaj , në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".